



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3681 Prot

Shkodër, më 09.03.2018

REZOLUTË Nr. 2

Mbi gjendjen e krijuar nga përmbytjet në territorin e Bashkisë Shkodër

Ne, të zgjedhurit vendorë me mandatin perfaqësues të banorëve të Shkodrës, anëtarë të këshillit bashkiak Shkodër, në mbledhjen e këshillit bashkiak sot në datën 9 Mars 2018, në Shkodër;

Të shtyrë nga mbrojtja e interesit legjitim të banorëve të Bashkisë Shkodër;

Duke parë gjendjen e rëndë të krijuar nga prezenca e lartë e ujit në njësitë administrative të Bashkisë Shkodër: Ana e Malit, Dajç, Gur i Zi, Bërdicë, Rrethinat, Velipojë;

Bazuar në parimet universalisht të pranura të demokracisë dhe vetëqeverisjes vendore, mbështetur Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 11; VKM Nr. 664, datë 18.12.2002 “Për kriteret dhe procedurat e shpalljes së gjendjes së emergjencave civile”

Duke vlerësuar gjendjen e rëndë reale të krijuar në terren, dhe më konkretisht:

1. niveli i ujit në zona të matshme arrin mbi 2 m (Obot, Goricë, Oblikë, Muriqan, etj);
2. deri në këto momente janë mbi 2285 Ha tokë e përmbytur;
3. lumi Buna dhe lumi Drin kanë dalë jashtë shtrati në përmasa të rrezikshme, duke rrezikuar seriozisht jetën e banorëve, gjësë së gjallë, pronën dhe pasurinë;
4. disa rrugë kalime për në qendrat e banuara (fshatin Obot, Goricë), janë të bllokuara nga uji.

Në cilësinë e anëtarëve të këshillit të bashkisë Shkodër, i kërkojmë Këshillit të Ministrave:

- Shpalljen e gjendjes së emergjencës civile te pjeshme në zonat e përmbytyra të Bashkisë Shkodër.

- Ngritjen e një Komiteti teknik në nivel Shtetëror për trajtimin definitiv për dhënien e zgjidhjeve të qëndrueshme dhe afatgjata të shmangies së përmbytjeve në zonën e nën-Shkodrës dhe më gjerë;
- Duke rishikuar Rregulloren e shkarkimeve të kaskadës;
- Pastrimi dhe thellimi i lumit Buna dhe studim/projektim/financim për mbrojtjen me argjinatura.

Miratuar në datën 09 Mars 2018

Sekretar i këshillit



Suel Hadri

KRYETAR




Xhemal BUSHATI